

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. Anila Çingo

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 7553 prot, datë 19.09.2023, ju bëjmë me dije se:

Nga verifikimet e kryera në Drejtorinë e Arkivit Qendror të ISSH, nuk rezultoi asnjë e dhënë sipas periudhave dhe subjekteve që keni specifikuar në kërkesë, me gjeneralitet Anila Çingo.

Për të vijuar me verifikime të mëtejshme, Drejtoria e Arkivit Qendror të ISSH, me anë të vërtetimit nr. 9640 prot, dt: 27.09.2023 ka kërkuar vënien në dispozicion të kopjes së librezës tuaj të punës, si dhe të specifikoni nëse keni mbiemër tjetër.

Nga data 1 maj 2022, në zbatim të VKM nr.252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, të gjitha aplikimet për shërbimet që ofron Instituti i Sigurimeve Shoqërore realizohen nëpërmjet portalit e-Albania.

Konkretisht, për verifikimin e periudhave të punës 2001 – 2004, duhet të aplikoni nëpërmjet portalit e - Albania, tek shërbimi elektronik “Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 01.01.1994 deri 31.12.2011”. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin për periudhat e punës për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore si i punësuar, pas datës 01.01.1994.

Për të realizuar këtë aplikim, fillimisht, duhet të identifikoheni si qytetare në portalin e-Albania dhe të përzgjidhni shërbimin “Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 01.01.1994 deri 31.12.2011”. Gjatë plotësimit të formularit i cili shfaqet në këtë aplikim duhet të përzgjidhni DRSSH Tiranë, në mënyrë që verifikimi të kryhet në Drejtorinë e Arkivit Qendror të ISSH dhe në seksionin III, të këtij formulari, në rubrikën “Dokumente që ngarkohen nga aplikanti” duhet të ngarkoni kopjen e librezës së punës të skanuar paraprakisht.

Aplikim juaj do të trajtohet nga struktura përgjegjëse dhe vërtetimi do t'ju gjenerohet në portalin e-Albania, në seksionin "Dokumentet e mia", brenda afateve zyrtare.

Bashkëngjitur shkresës, ju dërgojmë vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Arkivit Qendror nr.9640 prot, datë 27.09.2023, në emër të znj. Anila Çingo.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.